

RAPORT MUJOR I FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT “ALBSIG”**PRILL 2025****Emërtimi i Fondit:** Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur, Smart Pension (“Fondi”)**Shoqëria Administruese:** Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kollective, Albsig Invest sh.a.**Monedha Bazë:** Lekë

Politika e Investimit: Fondi ka një tolerancë të ulët rreziku (konservator) duke respektuar parimin e sigurisë, diversifikimit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm për investimet afatgjata. Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi (obligacione) afatgjatë të emetuar ose të garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Objektivi i investimit është rritja e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe horizonti i investimit është afatgjatë.

PROFILI I RREZIKUT DHE PËRFITIMIT**RREZIK I ULËT***Përfitime zakonisht të ulëta***RREZIK I LARTË***Përfitime zakonisht të larta*

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Fondi bie në kategorinë e parë të profilit të rrezikut, e cila është kategoria me rrezikut më të ulët. Kategoria e rrezikut përbën një rrezik sintetik i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e Fondit. Luhatshmëria e lartë ka një indikator rreziku më të lartë dhe një luhatshmëri më e ulët ka një indikator rreziku më të ulët.

Të dhënat kryesore për Fondin më 30.04.2025


Vlera Neto e Aktiveve :	796,834,671.59
Çmimi për kuotë:	1,170.95
*Kthimi nga Investimit (30 Prill 2024-30 Prill 2025):	4.23%

Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.*KOSTOT DHE TARIFAT**

- Komisioni vjetor i administrimit do jetë 2.5% në vit e vlerës neto të aktiveve të Fondit.

SHPËRNDARJA E AKTIVEVE

Kategoria e Aktiveve	Vlera (në lekë)	% ndaj Aktiveve
Tituj të emetuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.	746,757,306	93%
Llogari rrjedhëse dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë.	53,289,810	7%

ECURIA E ÇMIMIT PËR KUOTË DHE PERFORMANCA E FONDIT.


Kthimi vjetorë neto rezulton 4.23% për periudhën 30 Prill 2024-30 Prill 2025.

Më poshtë shfaqen kthimet vjetore të Fondit për periudhat 2 vjeçare, 3 vjeçare, dhe 5 vjeçare deri më 30 Prill 2025. Performanca e kaluar nuk duhet të përdoret si udhëzues për performancën në të ardhmen. Fondi ka filluar aktivitetin në **19.02.2020**.

Albsig	5Y	3Y	2Y	1Y
Norma Vjetore e Kthimit	3.15%	3.81%	4.12%	4.23%